

Shoqata e kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

LIGJET DHE TATIMET NË KOSOVË

(Zgjidhjet)

P4

Nr.

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Udhëzime/Instructions:

1. MOS E HAPNI DERISA T'IU LEJOHET PREJ MBIKËQYRËSIT
Do Not Open Until Your Invigilator Allows You to Do So.
2. ËSHTË E DETYRUESHME PËRGJIGJA E GJITHA PYETJEVE
All Questions Are Mandatory
3. KOHA E LEJUAR ËSHTË 3 ORË
Time Allowed is 3 Hours
4. EMRI JUAJ NUK DUHET TË PARAQITET NË ASNJË FLETË TË KËTIJ PROVIMI.
Your name should appear nowhere in this test.

Data 22.07.2017

**Pjesa A. Pyetjet “rumbullakos përgjigjet”
secila**

Nga 1 pikë

1. Bazuar ne Ligjin Për Shoqëritë Tregtare: Nëse një subjekt është i angazhuar në veprimtari tregtare në Kosovë pa e bërë regjistrimin paraprak të shoqërisë tregtare sipas këtij ligji me qëllim të ushtrimit të kësaj veprimtarie, atëherë ky subjekt do te jete objekt i gjobitjes.

E saktë

E pasaktë

2. Kapitali themeltar për një Shoqëri Aksionare(Sh.A) sipas Ligjit Për Shoqëritë Tregtare është me se paku 5,000.00 EUR.

E saktë

E pasaktë

3. Shoqëria tregtare mund të themelohet dhe regjistrohet për çfarëdo qëllimi të ligjshëm dhe mund të kryejë çfarëdo veprimtarie të ligjshme dhe te pa ligjshme.

E saktë

E pasaktë

4. Zyra e regjistrimit të Shoqërive Tregtare dhe Emrave Tregtar në Kosovë themelohet si një agjenci e pavarur ekzekutive në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

E saktë

E pasaktë

5. Një person ose shoqëri tregtare e cila ka për qëllim ta shfrytëzojë një emër tregtar brenda një afati vijues prej njëqindetëdhjetë (180) ditësh mundet, ta rezervojë shfrytëzimin ekskluziv të këtij emri tregtar.

E saktë

E pasaktë

6. Sipas Ligjit "Për Shoqëri Tregtare", shoqëria aksionare nuk duhet të ketë medoemos aksione të thjeshta dhe nuk duhet të emetojë medoemos aksione të thjeshta

E saktë

E pasaktë

7. Sipas Ligjit Nr. 04/L-014 "Për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim", Shoqëritë tregtare të mëdha në Kosovë sipas të këtij ligji duhet të aplikojnë SNK/SNRF dhe interpretimet, rekomandimet dhe këshillimet e nevojshme të lëshuara nga Bordi për Standarde Ndërkombëtare të Kontabilitetit të cilat miratohen nga KKRF-ja.

E saktë

E pasaktë

8. Shoqëritë tregtare, subjekte të ligjit "Për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim", duhet të verifikojnë të paktën një herë në gjashtë muaj, ekzistencën dhe vlerësimin e aseteve, të detyrimeve dhe të kapitalit, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe evidencës së tyre mbështetëse nëpërmjet procesit të inventarizimit.

E saktë

E pasaktë

9. Këshilli i Kosovës Për Raportim Financiar (KKRF) përbëhet nga tetë (8) anëtarë.

E saktë

E pasaktë

10. Sipas Ligjit Nr. 04/L-014 "Për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim" dhe udhëzimit administrativ, shoqëritë tregtare të mëdha, të mesme dhe të vogla që kanë status juridik, pasqyrat financiare duhet të përgatiten sipas standardeve ndërkombëtare për raportim financiar (IFRS) të plota.

E saktë

E pasaktë

11. Bazuar ne Ligjin Për Administratën Tatimore dhe Procedurat si dhe ne udhëzimet përkatëse administrative, çdo person jo-rezident i cili i nënshtrohet çfarëdo tatimi në Republikën e Kosovës në pajtim me legjislacionin tatimor të Republikës së Kosovës, do të caktojë një përfaqësues fiskal përpara se të fillojë ndonjë veprimtari ekonomike në Republikën e Kosovës. Përfaqësuesi fiskal do të regjistrohet në ATK brenda pesë (5) ditëve pasi të jetë emëruar.

E saktë

E pasaktë

12. Sipas Ligjit Nr. 03/L-222 Për Administratën Tatimore dhe Procedurat, blerjet për të cilat një faturë është lëshuar duhet të futet në librin e blerjeve brenda 5 ditëve pas pranimit të faturës së blerjes. Shitjet për të cilat një faturë e shitjes është lëshuar duhet të futet në librin e shitjeve brenda 5 ditëve pas lëshimit të faturës së shitjes.

E saktë

E pasaktë

13. Sipas Ligjit Nr. 03/L-222 Për Administratën Tatimore dhe Procedurat renditja e pagesave tek tatimpaguesit nga shpenzimet e mbledhjes e deri te interesi bëhet sipas vullnetit te vet tatimpaguesit:

E saktë

E pasaktë

14. Mospagesa e detyrimit tatimit ne kohen e parapare me ligjet tatimore, bazuar ne Ligjin Për Administratën Tatimore dhe Procedurat do te paguaje një gjobë prej 1% ne muaj apo pjesë te muajit, por jo me shume se 12 %(12 muaj).

E saktë

E pasaktë

15. Mospagesa e detyrimit tatimit ne kohen e parapare me ligjet tatimore, bazuar ne Ligjin Për Administratën Tatimore dhe Procedurat gjegjësisht vendimit te qeverisë nga data 01 Janar 2017 do te paguaje një interes prej 0.70% ne muaj apo pjese te muajit për periudhën e vonuar.

E saktë
E pasaktë

16. Sipas Ligjit Për Administratën Tatimore dhe Procedurat, çdo shumë e tatimit e paguar mbi shumën e detyrimit tatimor, me kërkesën e tatimpaguesit do të kreditohet ndaj detyrimit aktual të tatimpaguesit vetëm për detyrimin tatimore të njëjtë.

E saktë
E pasaktë

17. Sipas Ligjit nr .05/L-028 Për Tatimin në të Ardhurat Personale, interesi në instrumentet financiare të cilat janë të lëshuara apo garantuara nga një Autoritet Publik i Kosovës i paguar tatimpaguesve rezident apo jo rezident është e ardhur e tatueshme.

E saktë
E pasaktë

18. Sipas Ligjit nr. 05/L-028 Për Tatimin në të Ardhurat Personale me Pagat kuptoj me kompensimi financiar ose llojet e tjera të kompensimit, duke i përfshirë mallrat, bonuset, favoret, shërbimet ose shkëmbimet që paguhen në lidhje me punësimin në Kosovë.

E saktë
E pasaktë

19. Sipas Ligjit nr. 05/L-028 Për Tatimin në të Ardhurat Personale me Rezident kuptojmë: Personi fizik i cili ka vendbanim kryesor në Kosovë ose është fizikisht i pranishëm në Kosovë brenda 183 ditëve gjatë çdo periudhe 12 mujore ose Entiteti, Ndërmarrje personale afariste, Ortakëria apo Shoqëria e personave që është themeluar jashtë Kosovës por që planifikon ta ketë vendin e tij të menaxhimit efektiv në Kosovë.

E saktë
E pasaktë

20. Sipas Ligjit nr. 05/L-028 Për Tatimin në të Ardhurat Personale, periudha tatimore për bizneset individuale që kanë një qarkullim nën 50 000 EUR dhe që nuk janë të regjistruar në fitimin real, është çdo tremujorësh.

E saktë

E pasaktë

21. Sipas ligjit nr. 05/L-029 Për Tatimin ne te Ardhurat e Korporatave, një tatimpagues me të ardhura vjetore bruto prej 50.000 euro apo më pak për të zgjedhur që të përgatitin pasqyrat financiare dhe të paguaj tatim ne fitimin real duhet të dorëzojë një kërkesë për regjistrim në ATK, deri më 1 Mars të vitit aktual për të cilin tatimpaguesi kërkon te regjistrohet.

E saktë

E pasaktë

22. Sipas ligjit nr. 05/L-029 Për Tatimin ne te Ardhurat e Korporatave, Të ardhurat e Bankës Qendrore të Kosovës dhe të institucioneve financiare qeveritare ndërkombëtare të lejuara dhe të autorizuara për të vepruar në Kosovë janë te ardhura te përjashtuara.

E saktë

E pasaktë

23. Sipas ligjit nr. 05/L-029 Për Tatimin ne te Ardhurat e Korporatave , çdo humbje nga shitja apo këmbimi i pasurisë në mes të personave të lidhur konsiderohet shpenzim i pa zbritshëm.

E saktë

E pasaktë

24. Sipas ligjit nr. 05/L-029 Për Tatimin ne te Ardhurat e Korporatave, blerja e një pasurie për çmimin prej 1,000 euro ose me pake do të lejohet si shpenzim rrjedhës.

E saktë

E pasaktë

25. Sipas ligjit nr. 05/L-029 Për Tatimin ne te Ardhurat e Korporatave , zhvlerësimi i bagëtisë është i lejuar vetëm për bagëtitë të cilat rrisin pasardhësit vetëm për përdorim personal apo kafshë qumështore të përdorura vetëm për përdorim personal.

E saktë

E pasaktë

26. Sipas Ligjit te nr 05/L-029 Për Tatimin ne te Ardhurat e Korporatave , ofrimin e ndonjë Shërbimi të kryera në Kosovë nga personi jo resident për një periudhë apo periudha me shumë se nëntëdhjetë (90) ditë brenda një periudhe dymbëdhjetë (12) mujore nuk ka obligim për të krijuar ndërmarrje të përhershme ne Kosove.

E saktë

E pasaktë

27. Sipas ligjit te TVSh-se, personi i tatueshëm mund të kërkojë rimbursimin e TVSH-së nëse në fund të secilit tremujor kalendarik shuma e kreditit të TVSH-së tejkalon shumën prej 5,000 euro dhe me kusht që personi i tatueshëm të ketë qenë në gjendje kreditimi në fund të secilës periudhë tatimore të tremujorit, dhe nëse janë dorëzuar të gjitha deklaratat e TVSH-së dhe tatimeve tjera për të gjitha periudhat tatimore të kaluara.

E saktë

E pasaktë

28. Sipas ligjit te TVSh-se, për eksporte e rregullt, mund të kërkohet rimbursimi pas secilës periudhë tatimore pa ndonjë kusht paraprak.

E saktë

E pasaktë

29. Sipas ligjit te TVSH, çdo person është i obliguar që të regjistrohet për TVSH nga momenti i kalimit të qarkullimit prej tridhjetëmijë euro (30.000€), brenda vitit kalendarik dhe duhet të njoftojë ATK-në brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve kalendarike prej momentit kur ka lindur obligimi për regjistrim

E saktë

E pasaktë

30. Sipas ligjit te TVSH-se, vendi i furnizimit të shërbimeve për personin e tatueshëm, duhet të jetë vendi ku ky pranues e ka themeluar biznesin e tij

E saktë

E pasaktë

31. Sipas ligjit te TVSH-se, bizneset e huaja duhet te regjistrohen ne regjistrin e detyrueshem te TVSH-se nga momenti i fillimit e aktivitetit te tyre ne territorin e Kosovës

E saktë

E pasaktë

32. Sipas ligjit te TVSH-se, TVSH-ja ngarkohet sipas normës standarde 18% dhe normës se reduktuar 8%.

E saktë

E pasaktë

33. Sipas Ligji Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, dokument i cili personi i tatueshem i lëshon pranuesit te mallit ose shërbimeve pas lëshimit te faturës tatimore me qellim te korrjimit kur tatimi i ngarkuar ne atë fature tatimore është me i vogël sesa tatimi i mbetur borxh për atë furnizim te tatueshem quhet Notë Krediti:

E saktë

E pasaktë

34. Bazuar ne Ligjin e TVSH-se, personat e tatueshem ne momentin e regjistrimit për TVSH kane te drejte ta shfrytëzojnë TVSH e zbritshme për stokun e mbetur.

E saktë

E pasaktë

35. Sipas Ligjit te TVSH-se, person i tatueshem është secili person i cili është, ose kërkohet që të regjistrohet për TVSH dhe i cili në mënyrë të pavarur zhvillon një aktivitet ekonomik në Kosovë në mënyrë të rregullt apo jo të rregullt, pavarësisht nga qëllimi ose rezultati i atij aktiviteti ekonomik

E saktë

E pasaktë

36. Fondi i Kursimeve Pensionale i Kosovës është person juridik i pavarur nën mbikëqyrjen e Kuvendit të Kosovës i themeluar me qëllimin e vetëm dhe ekskluziv të administrimit dhe menaxhimit të llogarive individuale për pensionet e bazuara në kursime.

E saktë

E pasaktë

37. Sipas Ligjit mbi Pensionet në Kosovë, Sipas Ligjit mbi Pensionet në Kosovë, shuma maksimale e lejueshme vullnetare është 10% të pagës bruto për pjesën e punëdhënësit dhe 10% të pagës bruto për pjesën e të punësuarit.

E saktë

E pasaktë

38. Çdo punëdhënës është i obliguar që të kontribuojë në emër të punonjësve të vet në Fondin e kursimeve pensionale. Punonjësit obligohen që të kontribuojnë në emër të vet në kursimet pensionale. Obligimet e punëdhënësit dhe të punonjësit fillojnë në ditën e parë të punësimit të punëdhënësit për punonjësit që kanë krijuar marrëdhënie pune dhe përfundojnë kur punonjësi arrin moshën e pensionit.

E saktë

E pasaktë

39. Sipas Ligjit mbi Pensionet në Kosovë, vetëm Fondi i Kursimeve Pensionale i Kosovës, në rastet kur rrogat paguhen kryesisht në natyrë, punëdhënësi paguan pesë përqind (5%) të vlerës së tregut të pagesës në natyrë dhe punonjësi i paguan pesë përqind (5%) të vlerës së tregut të pagesës në natyrë.

E saktë

E pasaktë

40. Çdo punëdhënës është i obliguar që të kontribuojë në emër të punonjësve të vet në Fondin e kursimeve pensionale. Punonjësit obligohen që të kontribuojnë në emër të vet në kursimet pensionale. Obligimet e punëdhënësit dhe të punonjësit fillojnë në ditën e parë të punësimit të punëdhënësit për punonjësit që kanë krijuar marrëdhënie pune dhe përfundojnë kur punonjësi arrin moshën e pensionit.

E saktë

E pasaktë

41. Sipas Ligjit të Punës, nuk konsiderohet diskriminim, çdo dallim përjashtim ose dhënie e përparësisë, përkitazi me ndonjë vend të caktuar pune, në bazë të kritereve të caktuara që kërkohen për atë vend pune.

E saktë

E pasaktë

42. Sipas ligjit të Punës, puna e detyruar ose e dhunshme është e ndaluar pa përjashtim duke u përfshirë puna ose shërbimi të cilin e kryejnë personat e dënuar me aktgjykim të formës së prerë gjatë vuajtjes së dënimit apo edhe raste të gjendjes së jashtëzakonshme.

E saktë

E pasaktë

43. Sipas Ligji të Punës, kontrata për një detyrë specifike, nuk mund të jetë më e gjatë se njëqindnjëzet (120) ditë brenda një (1) viti.

E saktë

E pasaktë

44. Sipas Ligjit të Punës, orari i plotë i punës për të punësuarin, i cili është më i ri se tetëmbëdhjetë (18) vjeç, mund të jetë maksimum katërdhjetë (40) orë në javë.

E saktë

E pasaktë

45. Sipas Ligji të Punës për punët gjate natës pagesa shtese behet 30% me e larte se ne orët e zakonshme te punës.

E saktë

E pasaktë

Pjesa B. Pyetjet problemore

Problemi 1

10 pikë

Më poshtë është dhënë bilanci vërtetues i kompanisë tregtare FE Sh.p.k 31. 12. 2016.

	<u>Debit</u>	<u>Credit</u>
Banka	420,000	
Arka	420	
Llogarit e arketushme	125,000	
Stoku	120,000	
Makineri	250,600	
Zhvlerësimi I grumbulluar për makineri		131,762
Pajisje	24,592	
Zhvlerësimi I grumbulluar për pasje		14,549
Llogarit e pagueshme		9,200
Tatimi ne fitim	8,200	
Akrulaet		1,450
Kapitali themelor		25,000
Obligimi per Pensione		2,200
Obligimi për TAP		910
Pagat neto		21,090
TVSH		10,162
Fitimi I mbajtur		5,500
Te ardhurat		2,728,902
KMSH	1,185,000	
Shpenzimet e sigurimit	13,400	
Shpenzimet e komunikimit	6,300	
Uji	1,600	
Rryma	9,200	
Pensionet	26,400	

Sh. Bankare	1,735	
Zhvlerësimi	63,790	
Provizionet	10,183	
Trajnim stafi	3,150	
Donacion	17,585	
Shpenzimet e karburantit	16,023	
Shpenzime zyre	21,264	
Pagat	528,000	
Sh. profesionale	12,060	
Qiraja	22,636	
Shpenzimet e riparimit	927	
Shpenzimet e përfaqësimit	68,000	
Te ardhura tjera		5,340
TOTAL	<u><u>2,956,065</u></u>	<u><u>2,956,065</u></u>

Informacion shtesë:

1. Shpenzimet e karburantit- 25% e vlerës janë fatura te parregullta
2. Asetet ne bilancin vërtetues janë zhvlerësuar sipas politikave te kompanisë. Makineria i takon grupit te III sipas tatimeve ndërsa pajisjet i takojnë grupit te II. Te gjitha asetet janë blere para viti 2016.
3. 75% e shpenzimeve te donacionit janë te dokumentuara.
4. Provizioni nuk ka te bej me ndonjë llogari te veçanet te arketushme.
5. 20% e shpenzimeve te përfaqësimit nuk janë mbuluar me dokumentacion.
6. Qiraja për muajin Nëntor dhe Dhjetor do te paguhet ne Prill 2017 po ne te njëjtin muaji do te ndalet tatimi ne burim. Nuk ka pas ndryshim te qirasë nga Janari deri në Dhjetor.
7. Pagat e stafit për muajin Dhjetor do te paguhen ne Mars 2017. Nuk ka pas ndryshim te pagave nga Janari deri në Dhjetor.
8. Te ardhurat tjera – kane te bëjnë me shitjen e aseteve te grupit nga 1000-3000 i cili ne funde te viti 2015 është zhvlerësuar i teri, vlera kushtuese e këtyre asteve ka qen 11,100 EUR.

9. Te rishikohet çdo shpenzim i limituar sipas Ligjit “Për tatimi ne te ardhurat e korporatave”

Kërkohet:

Llogaritni obligimin tatimor pas rregullimeve te nevojshme bazuar ne Ligjin mbi te ardhurat e korporatave për kompaninë FE Sh.p.k. me 31.12.2016

Zgjidhje

Te ardhurat	2,728,902€
KMSH	(1,185,000€)
Fitimi Bruto	1,543,902€
SHP	(822,253€)
Te ardhurat tjera	5,340€
Fitimi Kontabël	726,989€

Rregullimet:

Sh. E karburantit(1*)	4,006€
Zhvlerësimi (2*)	33,812€
Donacioni	17,585€
Provizionet(4*)	10,183€
Sh.e përfaqësimit (5*)	40,711€
Qiraja(6*)	3,773€
Te ardhurat tjera(8*)	5,760€
Fitimi par Donacionit(3*)	842,818€
Donacioni	(13,189€)
Fitimi para tatimit	829,629€
Tatimi (10%)	<u>82,963€</u>

(1*) Shpz. E karburantit 16,023 x 25%= 4,006€ shpenzim i pazbritshem

		%	Zh. Tatimor	Zh. Kontabël	Diferenca
(2*) Makineria	250,600	10	25,060		
Pajisjet	24,592	20	4.918		

Total	29,978€	63,790€	33,812€(shpz.
-------	---------	---------	---------------

i

pazbritshem

(4*) Provizionet për llogarit e arktushme nuk janë shpenzime te periudhës për qëllime tatimore deri në vendim gjykate.

(5*) Te ardhurat $2,728,902 \times 1\% = 27,289\text{€}$ shpenzimet përfaqësimit të lejuar sipas ligjit

Te ndodhura $68,000\text{€} - 27,289\text{€} = 40,711\text{€}$ shpenzimet e përfaqësimit të papranuar për qëllimet tatimore.

P.S 20% e shpz. te përfaqësimit nuk janë mbuluar me dokumentacion por nuk kane efekt pasi qe vlera e tyre është 13,600€ dhe gjendet brenda 40,711€.

(6*) Qiraja $22,636\text{€}/12 = 1,886\text{€} \times 2 = 3773\text{€}$ shpz. i pazbritshem i periudhës, pasi qe ligji e kufizon çdo shpenzim qe lidhet me tatimin ne burim qe nuk paguhet deri me date 31 Mars te vitit ne vijim nuk do te jete shpenzim i kësaj periudhe.

(7*) Pagat janë paguar brenda Marsit te vitit ne vijim do te jete shpenzim i pranuar i periudhës.

(8*) Shitja e aseteve te grupit nga 1000-3000 njihet e ardhur e vitit sipas vlerës kushtuese dhe jo sipas vlerës se shitjes pra ne rastin ton 11,100

$11,100 \text{ (V.K)} - 5,340 \text{ (V.SH)} = 5,760\text{€}$ të ardhura shtese për qëllime tatimore.

(3*) Fitimi para donacionit $852,518 \times 10\% = 85,252\text{€}$ donacion i lejuar si shpz. sipas ligjit

Donacioni i ndodhur është 17,585€ dhe është brenda limitit te lejuar por për shkak e vetëm 75% e shpenzimit është i dokumentuar do te pranohet vetëm kjo pjesë si shpenzim ($17,585 \times 75\% = 13,189\text{€}$).

Problemi 2

5 pikë

Znj. Altina ne cilësinë e Menaxheres është punësuar ne kompaninë Avokatura II me date 01.05.2016, paga mujore është 800 Eur dhe një bonus ne dhjetore prej 10% e te ardhurës te këtij viti. Po ashtu ne këtë vite znj. Altina kishte te ardhura nga dividendata ne shumën prej 3,500 Eur.

Kërkohe:

Llogaritni detyrimin e tatimit dhe kontributin pensional te ndalur ne burim dhe i paguar nga kompania Avokatura II për Znj. Altina?

Llogarit detyrimin tatimore për deklaratën përfundimtare te Znj. Altina ?

Cila është diferenca ne mes tatimit te paguar dhe detyrimin për tu paguar?

Zgjidhje

Pagesat mujore

Paga bruto 800

Pensionet $800 \times 5\% = 40 + 40 = 80\text{€}$

TAP

$800 - 40 = 760\text{€}$ (baza për tatimi)

$0 - 80 = 0$

$80 - 250 = 4\% - 170 \times 4\% = 6.80$

$250 - 450 = 8\% - 200 \times 8\% = 16.00$

$450 - 760 = 10\% - 310 \times 10\% = 31.00$

TOTAL Mujor 53.80€

Bonusi $800 \times 8 \text{ (muaj)} = 6,400 \times 10\% = 640\text{€}$

KP për bonus $640 \times 5\% = 32 + 32 = 64\text{€}$

TAP për bonus $640 - 32 = 608\text{€}$ (baza e tatimit)

$608 \times 10\% = 60.80\text{€}$

Pagesat nga Avokatura II për Znj. Altina

KP

$80 \times 8 \text{ muaj} = 640$

Për bonus 64

TOTAL 704€

TAP

$53.80 \times 8 \text{ muaj} = 430.40$

Për bonus $= 60.80$

TOTAL 491.20€

Deklarata vjetore

(1*) Te ardhura nga Dividenta	3,500
Te ardhurat e tatueshme	
Te ardhurat e mujore	760 x 8 = 6,080
Bonusi vjetor i tatueshëm	608
TOTALI	6,688€

$$0 - 960 = 0$$

$$960 - 3000 = 4\% - 2040 \times 4\% = 81.60$$

$$3000 - 5400 = 8\% - 2400 \times 8\% = 192.00$$

$$\underline{5400 - 6,688 = 10\% - 1,288 \times 10\% = 128.80}$$

$$\text{Obligimi për TAP} \quad 402.40\text{€}$$

$$\text{Paguar} \quad (491.20)\text{€}$$

$$\text{Rimbursim} \quad -88.80\text{€ (diferenca e tatimit te paguar me obl.tatimor)}$$

(1*) Te ardhura nga Dividenta sipas ligjit për TAP janë te ardhura te përjashtuar për qëllime tatimore.

Problemi 3

15 pikë

Në vitin 2014 Investitori NDERTIMTARI fillon projektin për ndërtimin e objekteve banesorë- afaristi ne qytetin e Prishtinës . Ndërtesa do te ketë 3 hyrje, me lartësi 8 kate, me gjithsej 6,000 m2. Periudha e ndërtimit do të zgjasë 3 vite sipas planifikimit. Gjithsej të ardhurat sipas vlerësimit janë 6 milion euro. Shpenzimet e vlerësuara janë 3 milion e 300 mijë euro.

Ne vitin e I-re Kompania I nënshkruan 4 kontrata shitje

Te gjitha kontrata kane vlerën e shitjes 500,000 Eur, për te cilat u pranua avance 20% me rastin e nënshkrimit te kontratës, pagesat tjera do te vazhdojnë me 20% për secilin vit.

Ne vitin e II Kompania I nënshkruan 6 kontrata shitje

Te gjitha kontrata e vitit te dytë kane vlerën e shitjes 600,000 Eur, për te cilat u pranua avance 30% me rastin e nënshkrimit te kontratës, pagesat tjera do te vazhdojnë me 30% për secilin vit.

Ne vitin e III Kompania I nënshkruan 10 kontrata shitje

Te gjitha kontrata e vitit te tretë kane vlerën e shitjes 1,200,000 Eur, për te cilat u pranua avance 30% me rastin e nënshkrimit te kontratës, pagesat tjera do te vazhdojnë me 30% për secilin vit.

Kërkohet:

1. Llogarit tatimin ne fitim te kompanisë “ Ndertimtari“ për te ardhurat e tatueshme sipas Ligjit Për Tatimin ne te ardhurat e Korporatave për vitin e I,II dhe te III.
2. Cila është vlera e stokut te pa shitur te mbetur ne funde te periudhës se III sipas vlerës kushtuese.

Zgjidhje

Te ardhura gjate fazës se ndërtimit do te njihen sipas realizimit te parëse bazuar ne ligjin TAK. Ndërsa kostoja do te përlllogarit nga përqindja e te ardhurave te viti ne pjesëmarrjen e te ardhurave te përgjithshme.

Ne vitin kur përfundon projekti te ardhura do te njihe çdo e ardhur nga kontratat e nënshkruar qe akoma nuk janë njohure si te ardhura ndërsa kostoja vazhdon te njihet ne mënyre te njëjte mbi përqindjen e te ardhurave.

1. Viti i I

Te ardhurat nga paraja e pranuar për 4 kontrata $500,000 \times 20\% = 100,000\text{€}$
 Kostot ($100,000\text{€}/6,000,000\text{€} \times 100$)= 1.67%

Te ardhurat	100,000€
<u>Kostot ($3,300,000 \times 1.67\%$)</u>	<u>(55,110)€</u>
Fitimi i Para Tatimit	44,890€
Tatimi (10%)	4,489€

Viti i II

Te ardhurat nga paraja e pranuar

1. 4 kontrata viti I	$500,000 \times 20\% = 100,000\text{€}$
2. <u>6 kontrata viti II</u>	<u>$600,000 \times 30\% = 180,000\text{€}$</u>
Total i parasë viti II	280,000€

Kostot ($280,000/6,000,000 \times 100$)= 4.67%

Te ardhurat	280,000€
<u>Kostot ($3,300,000 \times 4.67\%$)</u>	<u>(154,110) €</u>
Fitimi i Para Tatimit	125,890€
Tatimi (10%)	12,589€

Viti i III

Te ardhurat nga paraja e pranuar

1. 4 kontrata viti I	$500,000 - 200,000 = 300,000\text{€}$
2. 6 kontrata viti II	$600,000 - 180,000 = 420,000\text{€}$
3. <u>10 kontrata e viti III</u>	<u>1,200,000€</u>
Total i parasë viti II	1,920,000€

Kostot ($1,920,000/6,000,000 \times 100$)=32 %

Te ardhurat	1,920,000€
-------------	------------

<u>Kostot (3,300,000 x 32%)</u>	<u>(1,056,000€)</u>
Fitimi i Para Tatimit	864,000€
Tatimi (10%)	86,400€

2. Stoku i mbetur

Viti I Kostot (3,300,000 x 1.67%)	55,110€
Viti II Kostot (3,300,000 x 4.67%)	154,110€
<u>Viti III Kostot (3,300,000 x 32%)</u>	<u>1,056,000€</u>
KMSH Total	1,265,220€

Stoku total	3,300,000€
<u>KMSH</u>	<u>(1,265,220)€</u>
Stoku i mbetur	2,034,780€

Problemi 4

10 pikë

“TIK” SH.P.K regjistroi blerje gjate Maj/2017 ne shumën Eur 20,000 me normën standarde; blerje ne shumën 10,000 EUR me normën e reduktuar; shitjet vendore ne ketë muaj Eur 40,000 me normën standarde dhe 6,000 EUR me normën e reduktuar (Vlerat e paraqitura janë pa përfshire TVSH-ne).

Ne muajin Maj 2017 “TIK” SH.P.K ka lëshuar një Notë Krediti për një blerës për shitje ne muajin Korrik 2016, vlera e TVSH-se ne ketë note Krediti është Eur 1,030(me normë standarde). Po në ketë muaj kompania pranoj një Notë Debiti nga një furnitor për blerjet e muajit Tetor 2016, vlera e TVSH-së në ketë notë Debiti është Eur 430 (me norme standarde). Gjithashtu ne ketë muaj TIK gjeti një faturë të muajit Dhjetor 2015 qe për shkaqe teknike nuk ishte regjistruar ne librat e blerjes. Vlera e kësaj fature ishte 6,500 Eur +TVSH (me normën standarde).

Kërkohet:

A ka detyrim TVSH-se për te paguar ne ketë muaj “TIK” SH.P.K”, nëse po sa është obligimi ?Plotëso deklaratën tatimore.

Zgjidhje

Libri i shitjeve

Shitjet me norme te reduktuar	$6,000 \times 8\% = 480\text{€}$
Shitjet me norme standarde	$40,000 \times 18\% = 7,200\text{€}$
TOTAL TVSH e llogaritur	7,680€

Libri i blerjeve

Blerjet me normën e reduktuar	$10,000 \times 8\% = 800\text{€}$
Blerjet me normën standarde	$20,000 \times 18\% = 3,600\text{€}$
Note krediti e lëshuar	$5,722 \times 18\% = 1,030\text{€}$
Note debiti e pranuar	$2,389 \times 18\% = 430\text{€}$
TOTAL TVSH e zbritshme	5,860€

TVSH e pagueshme = TVSH e llogaritur - TVSH e zbritshme

TVSH e pagueshme = 7,680 - 5,860€

= 1,820€ (për pagesë)

P.S

Fatura e gjetur e muajit Dhjetor/2015 nuk munde te regjistrohet për shkak te kufizimit kohore te ligjit. Muaji i fundit për te drejtën e regjistrimit ishte Dhjetori/2016 (pra periudha e fundit e vitit ne vijim).

Problemi 5**5 pikë**

Kompania HAM SH. A e cila kishte filluar aktivitetin ne kete vit, me date 31.12.2016 kishte ketë gjendje te aseteteve sipas kontabilitetit.

Vlera	Data e blerjeve
Sipas grupit	sipas grupeve
Grupi I - 250,500	05.07.2016
Grupi II - 90,000	02.03.2016
Grupi III - 350,000	04.04.2016 (50%) dhe 01.09.2016(50%)

Kërkohet:

Te llogaritet zhvlerësimi sipas Ligjit Për Tatimin ne te Ardhurat e Korporatave.

Zgjidhje

Grupi I - $250,500 \times 5\% = 12,525 / 2 =$	6,262.50
Grupi II - $90,000 \times 20\% =$	18,000.00
Grupi III $(350,000 / 2) = 175,000 \times 10\% =$	17,500.00
<u>Grupi III $(350,000 / 2) = 175,000 \times 10\% = 17,500 / 2 =$</u>	<u>8,750.00</u>
Totali i zhvlerësimit	50,512.50€

Problemi 6

5 pikë

LIMI sh.p.k. ka pranuar akt vendimin e raportit final te kontrolles nga ATK me datë 23 Mars 2017 për periudhën tatimore 10/2015 te TVSH. Aktvendim e raportit final rezulton me tatim shtesë ne shumë prej 12,300 Eur.

Kompani Limi SH.P.K për këtë periudhe kishte deklaruar dhe paguar me date 25.11.2015 obligimin tatimore prej 45,200 Eur

Kërkohet:

Sa janë gjobat dhe interesi për tatimin e nen deklaruar te dal nga kontrolli e ATK-se qe kompania duhet paguar duke u bazuar ne kalkulimet qe parasheh Ligji mbi Procedurat dhe Administratën Tatimore ?

Zgjidhje

1*Gjoba për nen deklarim tatimor	$12,300 \times 25\% = 3,075 \text{ €}$
2* Gjoba për mos deklarim ne kohe (1 muaj)	$12,300 \times 5\% = 615\text{€}$
3* Gjobe për mos pagese ne kohe (12 muaj)	$12,300 \times 12\% = 1,476\text{€}$
4* <u>Interesi (17 muaj x .65)</u>	$12,000 \times 11.05\% = 1,359 \text{ €}$
TOTALI	6,525€

1* Neni 52 pika 1.2 i ligjit për procedurat ATK-se- nëse nendeklarimi është me i larte se 10 % ndëshkimi është 25% i shumës se nendeklaruar.

2*Neni 51 pika 1 i ligjit Proc.ATK për mos deklarim te tatimit ne kohe ndëshkim 5% për muaj max 5 muaj. Ne rastin konkret kemi te bëjmë me 1 muaj vonese.

3*Neni 51 pika 2 i ligjit Proc.ATK për mos pagese tatimit ne kohe ndëshkim 1% për muaj max 12 muaj. Ne rastin konkret kemi te bëjmë me 12 muaj.

4* Neni 28 pika 1 i ligjit Proc.ATK-se, deri ne dite e pagese se tatimit llogaritet interes 0.65% ne muaj. Ne rastin konkret ne kemi te bëjmë me 17 muaj mos pagese te tatimit.

Problemi 7

5 pikë

Kompaninë “Holding Group” gjate Dhjetorit 2016 kishte blerje ne vlerë prej 60,000 EUR (norma standarde) dhe 10,000 EUR (norma e reduktuar); shitje vendore 90,000 (norma standarde); eksport 40,000 EUR dhe shitje te përjashtuara pa te drejt kreditimi Eur 400,000.

Përçindja e zbritjes se përdorur si koeficient gjate këtij vite ishte 80% ndërsa përçindja e koeficientit reale ne funde te këtij viti rezultojë te jete 60%. TVSH e blerjeve ne tersin Janar-Nëntor ishte 70,000

Kërkohet:

- a) Sa është rregullimi i TVSH ne deklaraten e Dhjetorit 2016 ?
- b) Plotëso deklaratë e Dhjetorit 2016 për TVSH te kompanisë Holdin Group?

Zgjidhje

a)

Koeficienti i përdorur	$70,000 \times 80\% = 56,000$
<u>Koeficient real</u>	<u>$70,000 \times 60\% = 42,000$</u>
Rregullimi i TVSH-se për pagese	14,000

Libri i shitjeve

Shitje te përjashtuar pa te drejte kreditimi	400,000
Eksport	40,000
Shitjet me norme standarde	$90,000 \times 18\% = 16,200\text{€}$
<u>Rregullimi i TVSH-se</u>	<u>14,000€</u>
TOTAL TVSH e llogaritur	30,200€

Libri i blerjeve

1* Blerejt pa TVSH	32,640
Blerjet me normën e reduktuar	$10,000 \times 8\% = 800 \times 60\% = 480\text{€}$
<u>Blerjet me normën standarde</u>	<u>$60,000 \times 18\% = 10,800 \times 60\% = 6,480\text{€}$</u>
TOTAL TVSH e zbritshme	6,960€

TVSH e pagueshme = TVSH e llogaritur - TVSH e zbritshme

$$\begin{aligned} \text{TVSH e pagueshme} &= 30,200 - 6,960 \\ &= 23,240\text{€ (për pagese)} \end{aligned}$$

1* NR

$$10,000 \times 40\% = 4,000\text{€}$$

$$800 \times 40\% = 320\text{€}$$

NS

$$60,000 \times 40\% = 24,000\text{€}$$

$$\underline{10,800 \times 40\% = 4,320\text{€}}$$

Blerjet pa TVSH 32,640€